

**BEQIR META****QËNDRIMI I SHTETIT SHQIPTAR NDAJ PAKICËS  
ETNO-KULTURORE VLEHE DHE ASAJ MALAZEZE  
NË VITET 1920-1924**

Në momentet e para të jetës së pavarur të shtetit shqiptar doli në pah edhe problemi i minoriteteve. Ndonëse u bënë përpjekje për të krijuar një kuadër ligjor, kjo detyrë nuk u arrit plotësisht, pasi Shqipëria kishte ende shumë probleme të mprehta për të zgjidhur. E rëndësishme është të theksohen dy tendenca kryesore. *Së pari*, u ruajt e gjithë statukuoja e mëparshme e jetës politike, kulturore, arsimore e sociale e minoriteteve. *Së dyti*, u bënë përpjekje për ta rritur standardin e të drejtave të minoriteteve.

Dokumenti më i rëndësishëm i kësaj periudhe ishte Deklarata që bëri Fan Noli në emër të shtetit shqiptar në Lidhjen e Kombeve në 2 tetor 1921 e cila përcaktonte një qëndrim shumë liberal ndaj minoriteteve kombëtare dhe grupeve të tjera etno-kulturore. Qysh nga kjo kohë shteti shqiptar e zbatoi me korrektësi këtë deklaratë përmbajtja dhe historia e së cilës nuk do të trajtohen në këtë artikull por do të bëhen objekt i veçantë studimi në një rast tjetër. Deklarata e 2 tetorit 1921 u ratifikua nga parlamenti shqiptar më 17 shkurt 1922 dhe instrumenti i ratifikimit u regjistrua në Sekretariatit e Lidhjes së Kombeve më 22 Mars 1922.<sup>1</sup>

Por në këtë kohë gjendja e brendshme politike e Shqipërisë nuk ishte e qetë dhe e stabilizuar. Propagandat e ndërhyrjet e Fuqive të huaja dhe vështirësitë e brendshme në ndërtimin e jetës shtetërore ishin të mëdha. Për këtë arsye u miratuan edhe ligje të jashtëzakonshme të cilat, ndonëse nuk drejtoheshin kundër minoriteteve, ndikonin për të disiplinuar jetën e tyre në kuadër të shtetit shqiptar. E tillë ishte edhe Ligja Ndëshkimore për Faje Politike e 9 prillit 1920<sup>2</sup>. Ky ligj ndalonte propagandën politike të çdo lloji që prishte sigurinë dhe qetësinë e brendshme (neni 1). Ndër propagandat e ndaluara ishin ato kundër kombësisë shqiptare, kundër flamurit kuq e zi, kundër mëvetësisë shqiptare, kundër gjuhës e shkronjave shqip, propagandat që kishin për qëllim ndërhyrjen apo kundërvënien e fesë ndaj politikës kombëtare, propagandat që

<sup>1</sup> Public Record Office, Foreign Office (më tej: FO) 371/7328, Notë e Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve.

<sup>2</sup> *Qarkoret e Ministrisë së P. Brendshme të vitit 1920*, f. 36.

sillnin armiqësi dhe ftohtësi midis feve të njohura dhe të nderuara në shtetin shqiptar. Këto akte dënoheshin me 3-15 vjet burgim.

Ndalohej dhe dënohej bashkëpunimi me shtete e komitete të huaja me qëllim që të krijonte ngatërresa të brendshme dhe kur cenonte qetësinë e Shqipërisë. Gjithashtu dënoheshin edhe ata persona që merrnin të holla prej shteteve e komiteteve të huaja për të realizuar qëllimet e lartpërmendura. Këta dënoheshin me vdekje. Të njëjtin dënim merrnin edhe ata që formonin ose merrnin pjesë në organizata antishqiptare, të cilat kishin për qëllim shkatërrimin e Shqipërisë dhe ata që shpërndanin armë dhe formonin banda të armatosura për të prishur qetësinë e vendit. Ky ligj ishte me fuqi të përkohshme, deri sa të vendosej qetësia në vend. Fajet politike do t'i gjykonte një gjykatë e posaçme në kryeqytet. Dënimet me vdekje nuk ekzekutoheshin pa miratimin e Këshillit të Lartë.

Pas Deklaratës së Përfaqësuesit të Shqipërisë për minoritetet, të gjitha autoritetet e shtetit shqiptar mblodhën të dhëna për pakicat e të gjitha llojeve. Nga ky hetim që u zhvillua në vitin 1922, rezultonte se në Shkodër, një pakicë mund të konsiderohej Vraca me 117 shtëpi e 897 banorë. Gjithashtu në katundin Kamicë kishte 14 shtëpi me 85 frymë, në Daragjat 9 shtëpi me 71 vetë dhe në qytetin e Shkodrës 180 shtëpi me 765 vetë të besimit ortodoks. Shumica e tyre cilësoheshin si vllahë të ardhur këtu prej kohërave të hershme, të tjerët ishin strugarë.

Prefektura e Drinit informonte se në atë qark kishte 15 kisha ortodokse e bullgare<sup>3</sup>. Prefektura e Korçës raportonte se atje kishte 2 kisha rumune dhe 2 shkolla rumune<sup>4</sup>. Prefektura e Peshkopisë raportonte se në krahinën e fushës kishte 7 kisha ortodokse, në krahinën e Gollobordës kishte 8 kisha ortodokse. Gjithsej në këtë qark kishte 15 kisha ortodokse bullgare. Nga tetë kishat e Gollobordës informohej se shumicën i kishte djegur ushtria serbe në operacionet e vitit 1920<sup>5</sup>. Përveç gjendjes sasiore të popullsisë dhe institucioneve arsimore e fetare të pakicave nga informacionet e prefekturave pasqyrohej edhe situata anarkike që mbizotëronte midis pakicave të ndryshme e cila ishte jashtë kontrollit të shtetit dhe në shkelje të Deklaratës shqiptare për minoritetet. Kështu në Prefekturën e Peshkopisë, prifti i fshatit Madric, Andon Bllazhef dhe ai i fshatit Drenok, Risto Marku kishin filluar të merrnin rroga nga Serbia dhe kishin çelur shkolla në gjuhën serbe në këto dy fshatra, të cilat ishin pjesë e zonës neutrale të Gollobordës, megjithëse si priftërinjtë e lartpërmendur ashtu edhe popullsia e katundeve në fjalë e konsideronin veten si bullgarë<sup>6</sup>.

<sup>3</sup> Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: *AQSh*), Fondi i Ministrisë së Brendshme (MPB), viti 1922, dos. 201, fl. 5, 27.

<sup>4</sup> *Po aty*, fl. 12. Prefektura e Korçës-MPB.

<sup>5</sup> *Po aty*, fl. 30. Prefektura e Peshkopisë-MPB, 22 mars 1922.

<sup>6</sup> *Po aty*, dos. 125, fl. 6. Prefekti i Dibrës, Neki Starova-MPB, 10 tetor 1922.

Priftërinjtë kishin si qëllim vetëm të përfitonin rrogën nga qeveria serbe. Prefektura e Peshkopisë bëri një marrëveshje me ta për t'u dhënë një rrogë prej 5 napolonash, me kusht që t'i mbyllnin shkollat serbe dhe të hiqnin dorë nga Serbia. Marrëveshja u pranua dhe priftërinjtë mbyllën shkollat serbe në muajin tetor 1922<sup>7</sup>.

Më 7 korrik 1922 qeveria shqiptare i dërgoi raportin zyrtar LK për gjendjen e minoriteteve në Shqipëri.<sup>8</sup> Në të thuhej se ligjet që ishin në fuqi, mënyra e trajtimit të minoriteteve, rregullat dhe praktika e vendit, siguronin plotësisht barazinë e të drejtave publike, civile dhe sociale, pa dallim race, gjuhe dhe feje.

Në Shqipërinë e Jugut raportohej se ekzistonte një minoritet grekofon prej 16.000 personash i cili kishte 36 shkolla, 2.614 nxënës, 49 mësues, 190 kisha dhe tempuj dhe 13 manastire greke. Të gjitha shkollat greke mbaheshin vetëm nga shteti i cili shpenzoi në vitin 1922 për mbajtjen e tyre 81.240 franga ari. Gjithashtu pohohej ekzistenca e një pakice prej 1.800 banorësh sllavofonë në zonën e Shkodrës e cila kishte 2 shkolla në gjuhën serbe. I vlerësuar në mënyrë proporcionale, numri i shkollave të këtyre pakicave ishte me i lartë se numri i shkollave për popullsinë shqiptare. Kishte një shkollë për 444 banorë grekofonë, dhe një shkollë për 1.800 banorë shqiptarë. Ky fenomen-thuhej në raport-nuk ndeshej në asnjë vend tjetër.

Por për arsye se Deklarata e vitit 1921, pa marrë parasysh specifikat e Shqipërisë dhe nën presionin e madh të vendeve fqinje, kishte parashikime edhe për grupet e popullsisë me kombësi shqiptare por që kishin besime të ndryshme, të cilat ishin cilësuar si pakica religjioze, qeveria shqiptare u detyrua të jepte të dhëna edhe për to. Ajo nënvizonte, para së gjithash, harmoninë dhe tolerancën fetare që mbizotëronte në vend. Si një shenjë domethënëse të harmonisë dhe të tolerancës fetare, qeveria shqiptare cilësonte edhe rezultatet e zgjedhjeve të vitit 1920, prej të cilave kishte dalë një numër më i madh deputetësh ortodoksë se sa përqindja e popullsisë shqiptare ortodokse. Po kështu, tolerante dhe gjithëpërfshirëse ishte edhe përbërja e Këshillit të Lartë Kombëtar. Edhe zyrtarët e departamenteve të ministrive ruanin këtë raport pozitiv. Ata kishin 98 zyrtarë myslimanë dhe 65 zyrtarë të krishterë. Komunitetet katolike dhe ortodokse shqiptare, nën autoritetin e krerëve të tyre, gëzonin statusin e entiteteve legale dhe kishin këto privilegje: Të drejtën që të mbanin kishat e tyre, konventat dhe pronat e kishave pa ndërhyrjen e shtetit; të drejtën e juridiksionit disiplinor mbi anëtarët e tyre; juridiksion të veçantë në çështjet e të drejtës familjare, si martesë, divorci, etj.; të drejtën për të pranuar dhe poseduar donacione dhe testamente në emrin e komunitetit; të drejta të plota

<sup>7</sup> Po aty, Fondi: Kryeministria, viti 1922, dos. IV-62, fl. 8. Prefektura e Dibrës-MPB, 18 tetor 1922.

<sup>8</sup> FO 371/ 7328. Raporti i qeverisë shqiptare (në anglisht), 7 korrik 1922.

për të hapur shkolla të niveleve të ndryshme që do të jepnin mësim në gjuhën e pjesëtarëve të atij komuniteti.

Leja që kërkohet më parë nën regjimin turk për ndërtimin ose riparimin e kishave, konventave ose për krijimin e fondacioneve bamirëse, tashmë nuk kërkohet më. Rregullat e neveritshme që ekzistonin gjatë regjimit turk për ndryshimin e fesë ishin hequr plotësisht dhe kishin ndodhur disa konvertime nga islami në katolicizëm. Në malet e Shqipërisë Veriore ndryshimi i fesë nga islame në katolike nuk kishte shkaktuar komente dhe nuk kishte provokuar pakënaqësi. Për më tepër, shteti shqiptar nuk njihte ndonjë fe zyrtare.

Siç e pohuam më lart, në përgjithësi spikati qëndrimi dashamirës dhe pozitiv ndaj pakicave. Ky qëndrim demonstrohet si në politikën shtetërore ashtu edhe në shtypin e kohës dhe në qëndrimet e opinionit publik. Kuptohet që afiniteti më i madh demonstrohet ndaj vllahëve. Këtyre ndjenjave i bënin jehonë veçanërisht shqiptarët e Rumanisë. Kështu gazeta “Shqipëria e Re” botoi një biografi të shkrimtarit të shquar me origjinë vllahë, Petru Vulkan. Ai ishte lindur në vitin 1870 në Ternovë të Manastirit. Prindërit e tij ishin vendosur në këtë fshat pas prishjes së Voskopojës. Gjithë jetën e tij ai ia kushtoi letërsisë arumune dhe, si gazetar i shquar, punoi për lirinë e shqiptarëve dhe të arumunëve. Gazeta bënte këtë vlerësim shumë të ngrohtë për këtë personalitet të kulturës arumune: “Ai është stolia e nëpunësve, shpresa e arumunëve dhe gëzimi i shqiptarëve”<sup>9</sup>.

Krahas qëndrimeve pozitive të cilat ishin dominuese, vihet re edhe një rrymë e shtypit shqiptar që fillon të botojë artikuj kritikë dhe sulme kundër vllahëve të Shqipërisë. Po japim një informacion më të detajuar për këtë fenomen vetëm për faktin se ka rëndësi për të studiuar dhe kuptuar konkretisht se virusi i nacionalizmit intolerant gjendej edhe në radhët e nacionalistëve shqiptarë, megjithëse fatmirësisht në një shkallë të papërfillshme. Njëra prej gazetave shqiptare të kohës, “E Vërteta”, që botohej në SHBA, në një numër të saj, i akuzonte vllahët për “krime” që kishin kryer ndaj shqiptarëve gjatë sundimit osman dhe se ata i kishin shërbyer Greqisë në kurriz të shqiptarëve. Akuzoheshin disa vllahë se kishin vrarë Spiro Kosturin e Vasil Negovanin në Manastir dhe veçanërisht kucovllahët e Përmetit, të cilët ia kishin shtypur kokën në mënyrë të tmerrshme At Stathit. Në këtë gazetë botohej kjo proverbë greke përbuzëse për vllahët: “Greku i bukur, shqiptari i mençur, turku barbar, bullgari gomar, kuco-vllahu hiç asgjë”<sup>10</sup>. Lidhur me vllahët e Korçës gazeta shkruante se ata jetonin shumë keq dhe se nuk kishin mësuar asnjë fjalë shqip. “Ata do t’i shikosh me shajakët e trasha në mes të gushtit dhe çobankat e tyre si i quan vendi, me tsibunë mbi gju pa këmishë dhe zbathur nga herë, lajnë me ujë

<sup>9</sup> Gjergj Bubani, “Biografi për shkrimtarin Petru Vulkan”, *Shqipëria e Re*, Kostancë, 11 shtator 1921.

<sup>10</sup> “Një ngjarje për t’u vënë re”, *E Vërteta*, St.Louis, Mo, 10 gusht 1920.

të ftohtë, duke i rrahur rrobat sepse s' dinë apo më mirë s' duan të dinë se ç' është uji i ngrohtë dhe sapuni. Nuk përdorin djepin për foshnja por i mbajnë në torbe..."<sup>11</sup> Vllehët, jo vetëm paraqiteshin si njerëz që nuk e donin qytetërimin, por akuzoheshin si kriminelë, si njerëz që ishin të shquar vetëm për keqbërje. Kështu thuhej se krerët e bandave shqiptare si: Shahin Matraku, Kajo Babjeni, Ismail Derdusha, Beqo Duda, Dajlan Kurteshi e të tjerë kishin nga një çetë të përbërë prej kuco-vllehësh, sepse ata vetë nuk kishin zemër të torturonin armiqtë e tyre, por ua ngarkonin këtë punë vllehëve, të cilët e kryenin me gjakftohtësi atë. Më të tmerrshëm në keqbërje e në ligësi cilësoheshin grabovarët dhe një çetë e tmerrshme nga ato fshatra që quheshin Kokoneshë, dëshira e të cilëve ishte vetëm keqbërja dhe asgjë tjetër.<sup>12</sup>

Në të vërtetë këto shkrime nuk kishin ndonjë qëllim të përcaktuar për të zhvilluar ndonjë propagandë kundër vllehëve por ato ishin produkt i grindjeve që zhvilloheshin herë pas here midis intelektualëve apo nacionalistëve shqiptarë, ku ndonjëri prej tyre, për të sulmuar kundërshtarin, përpiqej ta etiketonte atë si jo shqiptar apo të vinte në dyshim identitetin e tij shqiptar. Në rastin konkret e gjithë kjo urrejtje dhe ky vrer ishte derdhur mesa duket për të goditur atdhetarin e shquar shqiptar, Kristo Kirka të cilin e quanin një vllëh prej Pisoderi. Ai cilësohej edhe më i rrezikshëm se kriminelët që përmendeshin më lart, sepse, sipas gazetës, "ky hiqej si shqiptar, sepse ne, me një hipokrizi të çuditshme prej budallai, ka trembëdhjetë vjet që e kemi lënë të bëhet gangrenë e kryeqendrës sonë në Amerikë"<sup>13</sup>. Por gazeta akuzonte edhe Fan Nolin, i cili i kishte dhënë përkrahje Kirkës. Noli nuk cilësohej si kuco-vllëh por si evgjito-turk. Këta akuzoheshin se kishin përzënë nga "Vatra" Sotir Pecin, Faik Konicën, Kristo Floqin dhe shumë të tjerë.<sup>14</sup> E dhamë këtë shembull për të theksuar se raste të tilla sporadike, ndonëse ishin qëndrime jo miqësore dhe negative, nuk kishin si objekt pakicat por sidoqoftë ishin të dëmshme dhe cenonin atmosferën e përgjithshme miqësore që shqiptarët tregonin ndaj tyre. Këto qëndrime shpjegohen, më së shumti, me naivitetin dhe papjekurinë intelektuale dhe politike të intelektualëve apo personaliteteve të ndryshme të kohës.

Në këtë periudhë filluan të shfaqen kërkesat e para të vllehëve në disa fshatra për të hapur kishat dhe shkollat e tyre. Në fund të vitit 1920 disa fshatarë të Nicës, të drejtuar nga Gjorgji Prifti dhe Bani Janko, filluan përpjekjet për hapjen e shkollës rumune në këtë fshat, e cila kishte funksionuar në periudhën e sundimit osman. Ata morën udhëzime nga inspektori i shkollave

<sup>11</sup> "Kutso vlejhtë në Shqipëri", *po aty*, 10 gusht 1920.

<sup>12</sup> *Po aty*.

<sup>13</sup> "Po ne shqiptarët e padjallëzuar e zemërbardhë si u sillemi?", *po aty*, 10 gusht, 1920.

<sup>14</sup> *Po aty*.

rumune në Korçë, Ndini, që të kërkonin zyrtarisht rindërtimin e shkollës dhe të kishës rumune<sup>15</sup>. Për të gjetur një prift ata iu drejtuan dhespotit të Korçës, i cili u tha se duhej të caktonin një djalë që dinte rumanisht dhe ta dorëzonin prift. Mirëpo hasën në vështirësi pasi djemtë e fshatit nuk donin të bëheshin priftërinj<sup>16</sup>.

Në këto momente të vështira për shtetin shqiptar institucionet shtetërore nuk ishin të prirura të mbështesnin kërkesat për hapjen e shkollave rumune të cilat kishin ekzistuar në periudhën e fundit të sundimit osman ose të paktën përpqeshin të disiplinonin në përputhje me ligjet procesin e hapjes së shkollave rumune në Shqipërinë e Jugut. Nënprefektura e Pogradecit i kërkoi Prefekturës së Korçës, që të këshillonte inspektorin Ndini, miqësisht, se nuk ishte koha tani për të hapur shkolla dhe çështje të këtilla. Atij t'i thuhej se shqiptarët nuk e harronin miqësinë me Rumaninë dhe, kur të vinte koha, do t'ia shpërblenin asaj, por qeveria donte që, dorë për dorë, të mos hapeshin çështje të tilla, sepse ajo kishte marrë masa për të hapur shkolla dhe për arsimimin e nënshtetasve shqiptarë në gjuhën e shtetit (gjuhën shqipe)<sup>17</sup>. Prefektura e Korçës, nga ana e saj, i dha porosi Nënprefekturës së Pogradecit që të mos lejonte hapjen e shkollave të tilla pa pasur leje prej qeverisë. Edhe Ministria e Brendshme porositi Prefekturën e Korçës të mos jepte leje për hapjen e shkollës dhe kishës rumune në Niçë dhe të njoftoheshin nismëtarët për këtë<sup>18</sup>.

Me gjithë këtë vllhët arritën disa suksese. Në vitin 1921 u hapën katër shkolla vllhe në qarkun e Korçës, të cilat nuk kishin marrë lejen përkatëse nga autoritetet shtetërore. Prefektura e Korçës e lejoi hapjen e këtyre shkollave, duke u justifikuar se ato kishin funksionuar në kohët e mëparshme<sup>19</sup>. Ministria e Brendshme e miratoi këtë qëndrim dhe dha leje që të funksiononin shkollat vllhe në qytetin e Korçës, në Plasë të Sipërme dhe në Shipckë, në të cilat do të mësohej edhe gjuha shqipe<sup>20</sup>. Mirëpo Ministria e Arsimit nuk e pëlqeu këtë urdhër dhe e konsideroi atë jashtë kompetencës së Ministrisë së Brendshme. Ajo i kërkoi MPB të urdhëronte ndalimin e funksionimit të këtyre shkollave pasi urdhrin për funksionimin e tyre do ta jepte ajo ministri, në qoftë se do ta shihte të arsyeshme e të nevojshme<sup>21</sup>.

<sup>15</sup> *AQSh*, Fondi: MPB, viti 1920, dos.361, fl.4. Letër e Nënprefekturës së Pogradecit-Prefekturës Korçës, 11 nëntor 1920.

<sup>16</sup> *Po aty*.

<sup>17</sup> *Po aty*.

<sup>18</sup> *Po aty*. MPB-Prefekturës Korçës, 25 nëntor 1920.

<sup>19</sup> *Po aty*, viti 1921, dos.714, fl.1. Prefektura Korçë-MPB, 10 prill 1921.

<sup>20</sup> *Po aty*, Fondi i Ministrisë së Arsimit (MA), viti 1921, dos.39, fl.13. Drejtoria e Arsimit Korçë-MA, 14 maj 1921.

<sup>21</sup> *Po aty*, Fondi: MPB, viti 1921, dos.714, fl.3. MA-MPB, 4 qershor 1921.

Si edhe për disa çështje të tjera të trajtimit të problemeve të minoriteteve edhe për këtë çështje pati diferenca opinionesh dhe mospërputhje në veprimet e kompetencat e tyre ligjore. Kështu, Ministria e Brendshme u përpoq të bindte Ministrinë e Arsimit se veprimi i saj kishte qenë i drejtë. Ajo arsyetonte se ky vendim përputhej me angazhimet që kishte marrë shteti shqiptar në Lidhjen e Kombeve dhe se, për këtë rast duhej vepruar në mënyrë analoge me qëndrimet që ishin mbajtur ndaj shkollës serbe në Shkodër dhe shkollave greke në fshatrat grekofone të Gjirokastrës. Ajo e konsideronte të natyrshme rihapjen e atyre shkollave që i kishin pasur më parë vllahët e Shqipërisë, aq më tepër, kur këto shkolla nuk mund të sillnin ndonjë dëm, ashtu siç mund të sillnin shkollat greke e serbe. Madje çelja e tyre mund të ishte e dobishme, sepse do të siguronte simpatinë e Rumanisë, e cila prej më se 40 vjetësh, në kohë të vështira, kur gjuha shqipe persekutohej nga të gjitha anët, u kishte dhënë liri të plotë patriotëve shqiptarë<sup>22</sup>.

Mirëpo Ministria e Arsimit nuk u bind nga këto argumente. Ajo i kërkoi Kryeministrisë që ta diskutonte këtë çështje dhe shprehu pikëpamjen se hapja e atyre shkollave ishte e dëmshme, “sepse shumica e të krishterëve të Shqipërisë së Mesme, si dhe disa të krishterë të Shqipërisë së Jugut ishin vllahë nga gjuha, ç’ka do të ishte një dëm i madh për bashkimin tonë kombëtar”. Duke e çuar më tej argumentin e saj, Ministria e Arsimit theksonte: “MPB, sjell si shembull shkollat greke të Gjirokastrës. Por a është mirë që afër këtyre plagëve të çelen të tjera, që do të na bëhen pastaj një gangrenë për unitetin tonë nacional. A nuk duhet që ne të kemi qëllim të largët me gjet kohën e me e penguar, sa të jetë e mundur, veprimin e shkollave greke. Madje shkollat greke të Korçës dhe shkolla sllavishte e Shkodrës nuk kanë asnjë arsye ekzistence e duhen mbyllur menjëherë sepse në Korçë nuk ka grekë dhe as në Shkodër nuk ka sllavë. Vetëm në Prefekturën e Gjirokastrës mund të tolerohen shkolla greke sepse atje ka greqishtfolës”<sup>23</sup>. Është e qartë së në këtë konkluzion ka ekzagjerime edhe të vërteta. Çelja e shkollave vllehe nuk mund të dëmtonte as unitetin dhe as ekzistencën kombëtare të shqiptarëve pasi nuk ishte aspak e vërtetë që shumica e të krishterëve të Shqipërisë së Mesme dhe të krishterët e Shqipërisë së Jugut ishin vllahë. Ky ishte një gjykim që nuk bazohej në asnjë të vërtetë dhe nuk konfirmohet nga asnjë burim sado tendencioz që të ketë qenë. Ky pohim më së shumti mund të provojë se sa pak e informuar ishte për këtë çështje Ministria e Arsimit e asaj kohe. Nga ana tjetër ndeshet edhe një koncept nationalist pasi ekzistenca e shkollave greke në minoritetin grek në zonën e Gjirokastrës konsiderohen si plagë për unitetin kombëtar të shqiptarëve. Ndërsa qëndrimi ndaj shkollës greke të Korçës apo shkollës serbe në qytetin e Shkodrës ishte i

<sup>22</sup> *Po aty*, Fondi: MPB, viti 1921, dos. 714, fl. 4. MPB-MA, 4 qershor 1921.

<sup>23</sup> *Po aty*, Fondi: MA, viti 1921, dos.39, fl.2-4. MA-Kryeministrisë, 18 qershor 1921.

drejtë dhe në përputhje me ligjet ndërkombëtare për pakicat dhe parashikimet e traktateve të LK.

Në mbështetje të shkollave vllehe doli hapur gazeta “Shqipëria e Re” në Rumani. Kjo gazetë, që ishte organ i shqiptarëve të Rumanisë, botonte artikuj në gjuhën vllehe, redaktor i të cilëve në vitet 1920-21 ishte shkrimtari i njohur arumun Petru Vulçan. Ajo i vlerësonte arumunët si “mezi që lidhte e do të lidhë edhe në të ardhmen Rumaninë dhe Shqipërinë”, të cilët kishin luftuar përkrah shqiptarëve për lirinë e përbashkët dhe sot kishin gjithë të drejtat që të përfitonin të mirat që buronin prej kësaj lirie. “Arumunët gjetën dhe do të gjejnë kurdoherë tek shqiptari mikun e besës, gati t’u mbrojë interesat e tyre në ç’do therori, gati t’i përqafojë dhe t’i numërojë si vëllezër të tij. Shqiptarët gjetën në Rumani simpatinë e sinqertë vëllazërore, vendin e lirë ku mundën të strehoheshin nga ndjekjet e armikut”<sup>24</sup>.

Në këtë gazetë shkollat rumune cilësoheshin si shkolla që nuk kishin qëllime propagandistike dhe pikërisht ky ishte ndryshimi themelor me shkollat italiane, greke dhe serbe. Prandaj ajo kërkonte që shkollat rumune, jo vetëm që duheshin hapur, por qeveria shqiptare duhej t’i mbante ato me buxhetin e saj. Kështu edhe qeveria rumune do të ndiqte një politikë më miqësore ndaj çështjes shqiptare dhe do tua shpërblente më tepër shqiptarëve<sup>25</sup>.

Gazeta mbështeste dhe u bënte jehonë përpjekjeve të arumunëve të Pindit të cilët kishin filluar një lëvizje të gjallë për vetëqeverimin e këtij rajoni. Ata kishin përgatitur një memorandum të cilin do t’ia adresonin Lidhjes së Kombeve, Konferencës së Ambasadorëve dhe Konferencës së Londrës. Ajo shkruante se “populli shqiptar e shikonte me simpati të veçantë këtë lëvizje, sepse, përveç interesit të përbashkët që ka me vëllezërit arumunë të Pindit, ka dhe një lidhje shekullore gjaku”<sup>26</sup>. Autori i këtyre artikujve, Nik Pema, shkruante se ruajtja e autonomisë së Pindit ishte e pamundur pa bashkëpunimin e shqiptarëve, sepse të dy elementët kishin një lidhje natyrale dashurie, të cilën nuk e kishin elementët e tjerë që jetonin në Gadishullin e Ballkanit. Ai i bënte jehonë trajtimit të mirë dhe bashkëjetesës vëllazërore të shqiptarëve e arumunëve në shtetin e ri shqiptar. “Në Shqipëri populli arumun i ka të gjitha të drejtat fetare e arsimore. Në qytetin e Korçës ngrihet një kishë e famshme, në të cilën do të shërbehet në gjuhën rumune, shumë të holla janë dhënë nga qeveria dhe populli shqiptar për ngritjen e këtij tempulli të shenjtë. Shkollat janë të lira kudo që gjenden arumunë, të cilët mësojnë gjuhën e tyre. Me të drejtë mund të themi se në Shqipëri nuk ekziston çështje minoriteti. Në parlamentin e sotëm janë zgjedhur disa deputetë arumunë të cilët nuk konsiderohen si minoritet. Në bazë të popullsisë, arumunët nuk mund të zgjidhnin asnjë deputet, meqë nuk

<sup>24</sup> Gjergj Bubani, “România dhe Shqipëria”, *Shqipëria e Re*, 11 shtator 1921.

<sup>25</sup> M. Pirro, “Shkollat rumune në Shqipëri”, *po aty*, 30 korrik 1922.

<sup>26</sup> Nik Pema, “Autonomia e Pindit”, *po aty*, 4 shkurt 1923.

janë përqendruar në një vend ku mund të plotësojnë votat e duhura sipas ligjit të zgjedhjeve. Por simpatia që ushqen populli shqiptar për ta, bën që t'u japë votat e tij, pa marrë parasysh se janë elementë të ndryshëm<sup>27</sup>.

Gjithashtu kjo gazetë dënoi persekutimin e minoritetit arumun në Greqi dhe, veçanërisht, keqësimin e gjendjes së tij gjatë fushatës së shkëmbimit të popullsisë greko-turke, kur refugjatët e ardhur nga Azia e Vogël u vendosën në shtëpitë e pakicës vllehe. Ajo dënoi edhe sulmin që po bëhej kundër kishës dhe shkollave arumune në Greqi e Serbi, sidomos në krahinat e Maqedonisë, të Timokut dhe të Banatit serb<sup>28</sup>. Gazeta bënte thirrje që vëllazërimi midis shqiptarëve e arumunëve të forcohej më shumë dhe kështu, me fuqi të bashkuara, ata t'u bënin ballë rreziqeve që u kanoseshin<sup>29</sup>.

Duke u bazuar në deklaratën e qeverisë shqiptare për mbrojtjen e minoriteteve, deputeti i Elbasanit me origjinë arumune, A. Beça, së bashku me Ballamaçin, i kërkuan qeverisë së P. Evangjelit, leje për hapjen e shkollave rumune për vllahët. Kjo leje u ishte dhënë dhe në Korçë po funksiononte një shkollë rumune e financuar nga qeveria rumune. Më pas A. Beça kërkoi leje që të hapeshin shkolla për të gjitha komunitetet vllehe të Shqipërisë, të cilat të paguheshin nga qeveria shqiptare. Si shpërblim për këtë, qeveria rumune do të jepte 60 bursa për studentë shqiptarë që dëshironin të studionin në Rumani<sup>30</sup>.

Përveç debatit mbi numrin e shkollave rumune që duheshin hapur kishte edhe një debat tjetër, nëse duhej lejuar hapja e shkollave rumune apo e shkollave në gjuhën vllehe. Ministria e Arsimit sugjeronte që të studiohej mirë çështja, nëse vllahët e Shqipërisë ishin të njëjtë me rumunët e Rumanisë, pasi ata kishin dallime nga ana gjuhësore, si portugezët me spanjollët dhe, madje, më tepër se sa spanjollët me italianët. Kështu nuk duhej lejuar hapja e shkollave në gjuhën rumune në Shqipëri, por, për të mos i shkelur të drejtat e minoriteteve, shteti shqiptar mund t'u jepte leje vllahëve që të hapnin shkolla në gjuhën vllahishte<sup>31</sup>.

Megjithatë në Shqipëri funksiononin shkollat rumune. Edhe pse më 4 korrik 1922, ishte dhënë një urdhër nga Këshilli i Ministrave për mbylljen e shkollave private ai nuk ishte zbatuar për shkollat rumune, të cilat vijonin aktivitetin e tyre<sup>32</sup>.

Në fillim të vitit 1924 në Shqipëri funksiononin disa shkolla rumune. Në qytetin e Korçës funksiononin dy shkolla: një femërore dhe një tjetër

<sup>27</sup> *Po aty*, 25 shkurt 1923.

<sup>28</sup> A. Ktona, "Lëvizja e Arumunëve", *po aty*, 3 gusht 1924.

<sup>29</sup> *Po aty*.

<sup>30</sup> *AQSh*, Fondi: Kryeministria, viti 1922, dos.IV-62, fl.5. MA-Kryeministrisë, 12 qershor 1922.

<sup>31</sup> *Po aty*.

<sup>32</sup> *Po aty*, Fondi: MPB, viti 1922, dos.731, fl.13. MA-MPB, 5 tetor 1922.

mashkullore me katër klasë, me dy mësuese. Gjuha shqipe jepej qysh nga rendi i dytë e lart nga tre orë në javë. Mësuesit ishin nënshtetas shqiptarë, me përjashtim të njërit që ishte nënshtetas serb. Në katundin Plasë kishte një shkollë femërore e një mashkullore me dy mësues, njëri nënshtetas shqiptar dhe tjetri nënshtetas serb, ndërsa dy mësueset e shkollës femërore ishin nënshtetase serbe. Në katundin Shpërkë kishte vetëm një shkollë për djem me katër klasë, me një mësues, që ishte nënshtetas shqiptar<sup>33</sup>.

Në këtë kohë qeveria rumune filloi të aktivizohej për avancimin e shkollës rumune në vllahët e Shqipërisë. Ajo shtoi në buxhetin e saj të atij viti një shumë prej 2 milion lei për të çelur një lice në Korçë dhe disa shkolla fillore rumune në viset e tjera të Shqipërisë<sup>34</sup>. Ndërsa Administrata e Kishave dhe e Shkollave Rumune në Shqipëri kërkoi leje për hapjen e shkollave të reja rumune në Voskopojë, Dishnicë, Llëngë, Nicë dhe Grabovë, duke argumentuar se këto shkolla kishin funksionuar në kohën e Turqisë dhe të pushtimit grek, por ishin mbyllur gjatë Luftës së Parë Botërore<sup>35</sup>.

Mirëpo Ministria e Arsimit këmbëngulte vetëm në ruajtjen e statuskuosë së shkollave të mëparshme rumune dhe sugjeronte se duheshin ndaluar mësuesit me nënshtetësi serbe të jepnin mësim në këto shkolla<sup>36</sup>. Në shtator të këtij viti Prefektura e Korçës nuk lejoi një mësuese arumune, e ardhur nga Manastiri, me pasaportë serbe, që të jepte mësim në shkollën rumune të Plasës<sup>37</sup>. Gjatë tërë periudhës së qeverisjes së Nolit shërbimet fetare në kishat vllahë vijuan rregullisht, shkollat vllahë funksiononin por ishin ndaluar të jepnin mësim ato mësues që nuk ishin nënshtetas shqiptarë<sup>38</sup>. Këto masa duket se nuk e kënaqën qeverinë rumune. Edhe komuniteti arumun i Korçës protestoi për heqjen e dy mësuesve me nënshtetësi të huaj dhe kërkoi anulimin e këtij vendimi. Ndërsa shoqëria Maqedono-Rumune në Rumani planifikonte të protestonte tek qeveria rumune “mbi këtë sjellje jomiqësore” të qeverisë shqiptare. Madje edhe gazeta shqiptare “Shqipëria e Re”, e gjendur nën presionin e propagandës rumune, e cilësoi këtë qëndrim të gabuar sepse “nuk

<sup>33</sup> *Po aty*, Fondi: MA, viti 1924, dos.2, fl.5. Inspektoria e Arsimit Korçë-Prefekturës Korçë, 29 janar 1924.

<sup>34</sup> *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (më tej: AMPJ)*, viti 1924, dos.452, fl.2. MPJ-MA, 12 janar 1924.

<sup>35</sup> *Po aty*, Fondi: MA, viti 1924, dos.220, fl.2. Administrata e Kishave dhe e Shkollave Rumune në Shqipëri-Inspektorisë së Arsimit Korçë, 17 janar 1924.

<sup>36</sup> *Po aty*, Fondi: MPB, viti 1924, dos.273, fl.7. MA-MPB, 17 shkurt 1924.

<sup>37</sup> *Po aty*, dos. 155, fl. 6, 7. Zëvendësprefekti i Korçës, Ali Koprencka-MPB, 18 shtator 1924.

<sup>38</sup> *Po aty*, viti 1924, dos. 452, fl. 6-7. Prefektura e Elbasanit-MPJ, 27 tetor 1924; Prefektura e Korçës-MPJ, 28 tetor 1924.

ishte interesi ynë që të armiqësojmë një element në Shqipëri, i cili gjithmonë ishte përpjekur për të mirën e vendit dhe të shtetit shqiptar”<sup>39</sup>.

Për ta mbyllur këtë debat me palën rumune, Ministria e Jashtme sugjeroi që, për të kënaqur qeverinë rumune, në këtë moment delikat, kur Bukureshti po caktonte një ministër për në Tiranë, të lejohej të ushtronte profesionin edhe për disa muaj profesori i shkollës rumune që nuk kishte nënshtetësi shqiptare,<sup>40</sup>.

Problemi i arumunëve të Shqipërisë u parashtrua edhe në parlamentin rumun. Deputeti i shumicës në Dhomën e Deputetëve, I. Gradishteau kritikoi qeverinë për mosinteresimin e saj për “rumunët” e Shqipërisë. Ai kërkoi hapjen urgjente të Legatës Rumune në Shqipëri dhe pohoi se në këtë vend duhej të kishte 40-50 shkolla filllore dhe 2-3 shkolla të mesme rumune, si dhe një varg të tërë me konsullata që t’i ndihmonin këto<sup>41</sup>. Gjithashtu Gradishteau shprehu pakënaqësinë për funksionimin jo të mirë të atyre pak shkollave që kishin mbetur në Shqipëri, të cilat “po kalonin një jetë mizore, me sot e me nesër, as nuk ishin të inspektuara, as të lidhura me qendrën, as nuk kishin lidhje me ndonjë përfaqësues të shtetit rumun.” Duke evokuar një kërkesë të kahershme të qeverisë rumune për të fiksuar në Statutin Organik të Shqipërisë, garancitë e duhura për kishat dhe shkollat rumune, ai kërkonte që edhe qeveria rumune e vitit 1924 të kërkonte që të futeshin këto garanci në kushtetutën që do të miratonte Asambleja e re Kushtetuese e Shqipërisë. Mirëpo ai shprehte shqetësimin se qeveria rumune nuk kishte përfaqësues në Shqipëri për të mbrojtur interesat dhe pikëpamjet e saj, prandaj kërkonte hapjen e Ambasadës në Tiranë para se të votohej Kushtetuta e Shqipërisë, e cila në mungesë të prezencës rumune nuk do të merrte parasysh interesat rumune, ndonëse Shqipëria ishte një shtet miqësor ndaj Rumanisë<sup>42</sup>.

Në interpelancën e tij, Gradishteau gjithashtu parashtronte edhe objektivat dhe konceptet e politikës rumune në lidhje me arumunët e Shqipërisë. Ai pohonte se, përveç grekëve, shqiptarët ishin të vetmit në Ballkan që nuk ishin sllavë. Me pozicionin e tyre gjeografik, buzë detit Adriatik, ata mund të ishin ura e bashkimit midis Rumanisë dhe motrës së saj të madhe-Italisë dhe tërë Perëndimit. Ai jepte një shifër të ekzagjeruar të pakicës rumune në Shqipëri, duke e cilësuar atë si më të rëndësishmen në këtë vend, që përbënte 10% të popullsisë së Shqipërisë. Ai gjithashtu i vlerësonte arumunët si popullsinë më punëtore, më të arsimuar dhe më të qytetëruar të Shqipërisë, e cila i ishte përkushtuar shtetit ku jetonte dhe dëshironte të punonte për ta lulëzuar atë, duke dashur njëkohësisht të mos humbiste kombësinë rumune. Ai

<sup>39</sup> “Mbyllja e shkollave rumune në Shqipëri”, *Shqipëria e Re*, 19 tetor 1924.

<sup>40</sup> *AMPJ*, viti 1924, dos.452, fl.14. MPJ-Prefekturës së Korçës, 20 nëntor 1924.

<sup>41</sup> “Interpelanca e I. Gradishteau në Dhomën e Deputetëve të Rumanisë”, *Shqipëria e Re*, 18 maj 1924.

<sup>42</sup> *Po aty*.

pohonte se këta rumunë duan të bëhen pionierët e ekspansionit tonë kulturor dhe ekonomik edhe në Shqipëri, edhe përtej Adriatikut.

Gradishteau i paraqiste arumunët e Ballkanit si një popullsi që u ishte mohuar kultura rumune. Përpara Luftërave Ballkanike, Turqia Evropiane kishte katër inspektorë të shkollave rumune: Në rrethin e Selanikut kishte 29 shkolla fillore dhe një të mesme; në rrethin e Epirit kishte 27 shkolla fillore e një të mesme; dhe në Shqipëri 12 shkolla fillore e një të mesme, e cila ishte në Berat. Për përhapjen e kufizuar që kishin pasur shkollat rumune në Shqipëri gjatë sundimit turk, ai rendiste tre faktorë: indiferencën e qeverisë rumune, mungesën e komunika-cioneve në Shqipëri dhe politikat specifike frenuese të Turqisë, e cila në territorin e Shqipërisë nuk ishte shumë e gatshme të jepte lejen për çeljen e shkollave rumune. Kjo sepse Sulltan Abdyl Hamiti e mbështeste autoritetin dhe absolutizmin e tij më tepër mbi elementët shqiptarë muhamedanë dhe kishte frikë nga zhvillimi i një ndërgjegje kombëtare shqiptare<sup>43</sup>.

Edhe shtypi rumun kritikoi qeverinë rumune për mosnjohjen e shtetit shqiptar, duke shkaktuar në qarqet e politikës shqiptare dyshime se Rumania donte kështu të përkrahte disa lakmi tokësore të Greqisë e të Serbisë. Kështu, sipas revistës “Tribuna e Vlllehëve”, Rumania “po merrte përgjigje me të njëjtën monedhë mbi ca çështje që nuk ditëm t’i çmojmë në çastin e duhur”<sup>44</sup>. Por njëkohësisht kjo revistë kritikonte shtetin shqiptar për qëllimet “armiçësore” ndaj vlllehëve duke theksuar se qeveria shqiptare kishte kundërshtuar kategorikisht rihapjen e shkollave rumune<sup>45</sup>. Kuptohet këtu bëhej fjalë për hapjen e shkollave të tjera përveç atyre që funksiononin.

Në vitin 1921 komuniteti arumun i Korçës u përpoq të rindërtojë kishën e tij. Në pamundësi për të siguruar mjetet e duhura monetare, ai i kërkoi qeverisë shqiptare ndihmë materiale<sup>46</sup>. Këshilli i Financave dha një përgjigje negative për këtë kërkesë, duke argumentuar se shteti nuk ndodhej në kondita të mira financiare. Gjatë diskutimeve në Këshillin Kombëtar, një shumicë deputetësh kërkoi që t’i rekomandohej qeverisë ta shqyrtonte këtë kërkesë. Stavro Vinjau theksoi se Këshilli i Financave ishte ndodhur në një gjendje të vështirë pasi, në një rën anë ai kishte parasysh shërbimin që i kishte bërë çështjes kombëtare shqiptare komiteti arumun dhe, në anën tjetër, ndodhej para vështirësive të mëdha financiare, prandaj nuk kishte mundur të jepte një përgjigje pozitive. Megjithëse në Shqipëri nuk kishte asnjë fe zyrtare dhe shteti shqiptar nuk kishte financuar ndonjëherë komunitetet apo ngritjen e objekteve të kultit, Komisioni i

<sup>43</sup> *Po aty*.

<sup>44</sup> “Shtypi rumun për Shqipërinë”, *Shqipëria e Re*, 22 qershor 1924.

<sup>45</sup> *Po aty*.

<sup>46</sup> *Bisedimet e Këshillit Kombëtar*. Legjislatura e Parë, viti 1921, Mbledhja e 55-të, 1 tetor 1921.

Financave sugjeroi që t'i shkruhej qeverisë të ndihmonte në një mënyrë që ta gjente të arsyeshme<sup>47</sup>. Edhe Hoxhë Kadriu evidentoi rezistencën e përbashkët të arumunëve dhe shqiptarëve kundër pushtimit dhe veprimeve të ushtrisë greke në vitin 1914 në Shqipërinë e Jugut dhe mbështeti ndihmën financiare që i duhej dhënë komunitetit arumun<sup>48</sup>.

Mirëpo në Parlament pati dhe një diskutim me karakter nacionalist si ai i deputetit S. Koja. Ai deklaroi se në Shqipëri kishte vetëm shqiptarë, kështu qeveria duhej të merrej vetëm me çështjen kombëtare dhe, meqë ky ishte një problem fetar, ajo nuk duhej të ndihmonte<sup>49</sup>.

Deputeti arumun A. Beça, vuri në dukje se në Shqipëri jetonte një popull fisnik, i cili kishte bashkëpunuar me nacionalistët shqiptarë dhe kishte luftuar kundër grekëve, të cilët i cilësoi si armiq të përbashkët të shqiptarëve dhe arumunëve. Në vitin 1914, ai vuajti së bashku me shqiptarët nga persekutimet e grekëve. Kryetari i arumunëve Papa Harallamb Ballamaçi, bashkë me 7-8 bashkëpunëtorë të tij, u vra prej grekëve për arsye se bashkëpunoi me nacionalistët shqiptarë. Arsye tjetër e vrasjes së tij ishte se ai ishte ndarë nga Patrikana e Stambollit dhe kishte hapur një kishë të vogël, në të cilën faljet bëheshin herë në gjuhën rumune e herë në gjuhën shqipe, pasi në atë kishë faleshin edhe nacionalistët shqiptarë, sepse në kishat e tjera meshohej vetëm greqisht. Prandaj ai kërkoi që qeveria të ndihmonte për rindërtimin e kësaj kisha. Kështu, Shqipëria do të jepte një provë se është një shtet konstitucional, në të cilin shtetasit e tij trajtoheshin në mënyrë të barabartë<sup>50</sup>. Parlamenti votoi një rekomandim për qeverinë që ajo t'i jepte ndihmë komunitetit arumun, duke pasur parasysh edhe gjendjen financiare të shtetit<sup>51</sup>.

Po në këtë kohë Ministria e Brendshme u dha leje vlllehëve të katundit Jorgucat që të rindërtonin dhe zmadhonin një kishë. Në përgjigjen që u jepte atyre Ministria e Brendshme thuhet: "Në Shqipërinë e lirë në se dëshironi mund të ndërtoni 100 kisha"<sup>52</sup>.

Qeveria shqiptare vijonte të mbante një qëndrim miqësor për të gjitha problemet ndaj vlllehëve. Duke u informuar për këtë qëndrim tolerant e miqësor të qeverisë shqiptare, shumë vlllehë nga Greqia erdhën në Shqipëri dhe kërkuan të merrnin nënshtetësinë shqiptare. Kështu për shembull, në prill të vitit 1922, Prefektura e Gjirokastrës njoftonte se vlllehë nga Mexhideja e Greqisë po kërkonin të futeshin brenda kufirit shqiptar, bashkë me familjet e tyre, që të stabilizoheshin përfundimisht në Shqipëri e të fitonin nënshtetësinë shqiptare.

<sup>47</sup> *Po aty.*

<sup>48</sup> *Po aty.*

<sup>49</sup> *Po aty.*

<sup>50</sup> *Po aty.*

<sup>51</sup> *Po aty.*

<sup>52</sup> *AQSh*, Fondi: MPB, viti 1921, dos.100, fl.6.

Ata kërkonin gjithashtu të mos paguanin taksa doganore për bagëtitë e tyre që do të sillnin<sup>53</sup>.

Qeveria urdhëroi që familjet vllehe të lejoheshin të vendoseshin në Shqipëri dhe të mos paguanin taksa<sup>54</sup>.

Për arsye të lëvizjeve të vazhdueshme të vllahëve midis Shqipërisë dhe vendeve ballkanike u krijuan edhe probleme administrative. Në vitin 1923 autoritetet shqiptare konstatonin se në Shqipërinë e Jugut gjendeshin disa familje vllehe, pa qendër banimi, që mbanin pasaporta greke, dhe të tjerë që nuk ishin regjistruar në zyrat e gjendjes civile. Deri në këtë kohë ata nuk ishin thirrur në shërbimin ushtarak. Këta kishin ardhur në Shqipëri qysh në kohën e Luftërave Ballkanike dhe nuk dëshironin e nuk guxonin të ktheheshin në Greqi nga frika e persekutimit grek<sup>55</sup>. Ministria e Luftës kërkoi që ata të regjistroheshin si shtetas shqiptarë dhe të thirreshin në shërbimin ushtarak.

Tendenca e përgjithshme e këtyre vllahëve nomadë ishte instalimi në Shqipëri, por kishte edhe raste të veçantë kur individë të ndryshëm nuk pranonin të regjistroheshin si shtetas shqiptarë, ose që preferonin nënshtetësinë greke, sepse këta në dimër qëndronin në Shqipëri kurse në verë shkonin në Greqi<sup>56</sup>. Për këtë arsye Ministria e Brendshme mori vendimin që prefekturat e Korçës dhe të Gjirokastrës të regjistronin si nënshtetas shqiptarë të gjithë ata vllahë që banonin në këto qarqe dhe nuk kishin dokumentet e nevojshme për të provuar nënshtetësinë e huaj<sup>57</sup>. Edhe Ministria e Jashtme ishte dakord që vllahët e regjistruar si nënshtetas shqiptar t'i nënshtroheshin shërbimit ushtarak. Atyre që nuk ishin regjistruar si të tillë t'u jepej një afat i arsyeshem për të rregulluar situatën e shtetësisë së tyre me qëllim që kështu të shmangej çdo shkak keqkuptimi me shtetet fqinje. Por në këtë kategori nuk do të futeshin vllahët që kishin dezertuar nga ushtria greke<sup>58</sup>.

Në vitin 1924 qeveria e Nolit u tregua edhe më e kërkuese ndaj pajisjes dhe kontrollit të dokumenteve të shtetësisë së vllahëve nomadë. Tashmë ato vllahë, që kishin vetëm dokumente të ushtrisë greke dhe jo pasaportë, detyroheshin të nxirrnin pasaporta nga konsullatat greke, në afate të arsyeshme. Në rast të kundërt ata nxirreshin jashtë Shqipërisë. Disa vllahë s'kishin asnjë lloj dokumenti dhe dëshironin nënshtetësinë shqiptare, por trembeshin nga qeveria greke e cila nuk u njihte zotërimin e pronave që kishin atje. Qeveria shqiptare vendosi që këta persona mund të merrnin atë nënshtetësi që dëshironin dhe pastaj do të pajiseshin me dokumente. Në rast se refuzonin t'i

<sup>53</sup> *Po aty*, viti 1922, dos.1279. Prefektura e Gjirokastrës-MPB, 10 prill 1922.

<sup>54</sup> *Po aty*, dos. 576, fl. 9. MPB-Prefekturës Gjirokastrë, 10 prill 1922.

<sup>55</sup> *Po aty*, viti 1923, dos.796, fl.51. Ministria e Luftës-MPB, 21 maj 1923.

<sup>56</sup> *Po aty*, fl.56-58. Prefektura e Korçës-MPB, 16 gusht 1923.

<sup>57</sup> *Po aty*, fl.66. Vendimi i MPB, nr.24, dt. 13 dhjetor 1923.

<sup>58</sup> *Po aty*, fl.53. MPJ-MPB, pa datë.

nënshtroheshin këtij rregulli do të nxirreshin jashtë Shqipërisë. Ata që kishin pasaporta greke liheshin të lirë të qëndronin brenda territorit shqiptar<sup>59</sup>.

### **Qëndrimi i qeverisë ndaj pakicës malazeze në zonën e Shkodrës**

Para se qyteti i Shkodrës dhe rrethinat e tij të bashkoheshin me shtetin shqiptar, kur Shkodra ishte nën sundimin e ushtrisë franceze, u çelën dy shkolla në gjuhën sllave, njëra për ortodoksët e qytetit dhe tjetra në Vrakë. Shkollën e Shkodrës e frekuentonin fëmijët ortodoksë të qytetit. Kjo shkollë në kohën e pushtimit austro-hungarez kishte qenë e mbyllur<sup>60</sup>. Këto dy shkolla e kishin vijuar aktivitetin e tyre dhe po mbaheshin prej shtetit jugosllav. Ato nuk i ishin nënshtuar asnjë kontrolli nga Inspektorja e Arsimit-Shkodër.

Vetëm në mars të vitit 1922, iu kërkua këtyre shkollave të paraqisnin programin e tyre. Informacioni që dhanë drejtoritë e tyre ishte shumë i mangët<sup>61</sup>. Ministria e Arsimit theksonte se të krishterët e Shkodrës, në më të shumtën e tyre, ishin shqiptarë, përveç fort pak familjeve nga raca sllave, por që edhe këto ishin shqiptarizuar qysh në kohën e Turqisë. Ato, qysh atëherë, si një minoritet fetar, kishin qenë nën mbrojtjen e Ruisë. Shteti malazez interesohej drejtpërsëdrejti për kishën dhe shkollën e tyre dhe, për interesa politike, financonte shkollën sllave. Mirëpo, megjithëse këto ortodoksë ishin shqiptarë, ata nuk kishin ndërgjegje të qartë kombëtare dhe midis tyre dominuese ishin ndjenjat fetare. Një pjesë e tyre e quanin veten sllavë dhe nuk pranonin të ndiqnin shkollat shqipe<sup>62</sup>. Ky qëndrim i shkonte përshtat interesave të shtetit jugosllav, i cili donte të ruante ato privilegje që kishte pasur Mali i Zi në kohën e Turqisë, domethënë synonte të ruante regjimin e kapitulacioneve dhe, për këtë qëllim, i financonte këto dy shkolla.

Ministria e Arsimit duke e konsideruar se ky veprim prekte sovranitetin e shtetit shqiptar, i sugjeroi Ministrisë së Jashtme t'i kërkonte qeverisë jugosllave të hiqte dorë nga financimi i këtyre dy shkollave. Ministria e Arsimit do të interesohej për mbarëvajtjen e tyre sikurse ishte duke vepruar për shkollat e pakicave të tjera<sup>63</sup>. Në rast të kundërt, ajo kërcënonte se do t'i mbyllte këto shkolla.

Edhe Ministria e Brendshme i sugjeroi Ministrisë së Jashtme që shkolla ortodokse e Shkodrës, që subvencionohej nga Serbia dhe ku mësohej vetëm serbisht, nuk mund të lejohej në një shtet të pavarur, por vetëm në një shtet që

<sup>59</sup> *Po aty*, viti 1924, dos.761, fl.1-2. MPB-Prefekturës Korçë, 3 tetor 1924.

<sup>60</sup> *Po aty*, viti 1920, dos. 361, fl. 1. Prefektura Shkodër-MPB, 7 gusht 1920.

<sup>61</sup> *AMPJ*, viti 1922, dos. 164, fl. 10-11. Ministria e Arsimit-MPJ, 16 shtator 1922.

<sup>62</sup> *Po aty*.

<sup>63</sup> *Po aty*.

kishte pranuar kapitulacionet<sup>64</sup>. Më parë ajo kishte porositur Prefekturën e Shkodrës që të jepte një informacion të saktë për përbërjen e popullsisë ortodokse të qytetit. Prefektura, pasi bëri hetime, informoi Ministrinë e Brendshme se shumica e ortodoksëve që mësonin në shkollën serbe flisnin shqip në shtëpitë e tyre<sup>65</sup>. Qyteti i Shkodrës kishte 170 shtëpi ortodokse me 705 frymë. Prej tyre 649 flisnin shqip në familje ndërsa 45 sllavisht dhe ishin nënshtrëtas jugosllavë<sup>66</sup>.

Ministria e Jashtme nuk e miratoi kursin që propozonin dy dikasteret e tjera të lartpërmendura dhe apeloj për veprime të kujdesshme. Ajo kërkonte që problemi të studiohej nga pikëpamja juridike dhe të kihej parasysh fakti se, në një kohë kur Jugosllavia kishte bërë hapin e parë për njohjen e Shqipërisë, përgjigja shqiptare me mbylljen e kësaj shkolle nuk do të ishte aspak e arsyeshme dhe e dobishme<sup>67</sup>. Ajo sugjeronte që të pritej derisa të akreditohej pranë qeverisë shqiptare përfaqësuesi jugosllav dhe pastaj të veprimeve sipas neneve të deklaratës për minoritetet në Shqipëri.

Në fshatin Vrakë të Shkodrës ekzistonte një komunitet i vogël malazez i cili kishte 151 shtëpi dhe 1.855 vetë. Ndryshe nga ortodoksët e qytetit të Shkodrës, banorët e katundit Vrakë flisnin sllavisht në familjet e tyre, por ata e dinin edhe gjuhën shqipe.

Ministria e Jashtme i filloi përpjekjet ndaj qeverisë jugosllave për ndalimin e subvencionit që ajo u bënte shkollave sllave në Shkodër e Vrakë. Meqë Deklarata për minoritetet lejonte çeljen e këtyre shkollave, ajo kërkoi financimin e këtyre shkollave nga buxheti i Ministrisë së Arsimit, i cili do të fillonte mbulimin e shpenzimeve të tyre që nga momenti kur ato do t'i dorëzoheshin autoriteteve shqiptare<sup>68</sup>.

Qeveria jugosllave u përpoq që të ruante kontrollin e saj mbi shkollat sllave të kësaj zone. Për ta përforcuar pozitën e saj në raport me çështjen e malazezëve të Vrakës, qeveria jugosllave u përpoq të përdorë edhe problemin e pazgjidhur të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare.

Në janar të vitit 1923, peshkopi serb Viktori erdhi në Shkodër dhe mori në dorë kishën e Shkodrës. Ky veprim ngjalli reagimin e Kryetarit të Këshillit të Lartë Kishtar, At Vasil Markos, i cili i tërhoqi vëmendjen qeverisë se kishte lejuar një peshkop ortodoks të huaj të vepronte në Shqipëri, pa miratimin e Kryekishës shqiptare. Ai e konsideroi veprimin e Viktorit si një akt që shkelte statutin e Kishës Autoqefale Shqiptare dhe kërkoi largimin e tij menjëherë nga

<sup>64</sup> *Po aty*, fl. 6. MPB-MPJ, 26 mars 1922.

<sup>65</sup> *AQSh*, Fondi: MPB, viti 1922, dos. 125, fl. 32. Prefektura e Shkodrës-MP Brendshme, 11 prill 1922.

<sup>66</sup> *AMPJ*, viti 1922, dos. 164, fl. 13. Ministria e Arsimit-MPJ, 23 tetor 1922.

<sup>67</sup> *Po aty*, fl. 7. MPJ-MPB, 29 mars 1922.

<sup>68</sup> *Po aty*, fl. 15. MPJ-Ministrisë së Arsimit, 8 nëntor 1922.

Shkodra<sup>69</sup>. Ministria e Brendshme u përpoq ta qetësonte At Markon, duke e garantuar se kishte marrë masat e nevojshme për largimin e tij dhe se do t'i qëndronte deri në fund këtij veprimi. Deri atëherë ishte dhënë urdhër që ai të ndalohej të drejtonte mesha në kishë<sup>70</sup>.

Ardhjen e dhespotit serb në Shkodër, At Vasil Marko e vlerësonte jo vetëm si një shkelje të Statutit të Beratit por edhe si një rrezik që do të krijonte precedentë të dëmshëm për politikën e shtetit shqiptar dhe qëndrimin e KOASH ndaj minoriteteve. Shqetësimi i tij ishte se ky veprim mund të ishte bërë në bazë të ndonjë marrëveshje me Patrikanën e Stambollit<sup>71</sup>. Edhe prefekti i Shkodrës mbështeste largimin e shpejtë të Viktorit. Ai mendonte se kështu, jo vetëm që do të qetësohej kryetari i Kishës Shqiptare, por edhe populli i Shkodrës dhe disa deputetë shkodranë, të cilët ishin përgatitur të zhvillonin një miting proteste<sup>72</sup>.

Mirëpo kishte edhe një alternativë pragmatiste dhe më të butë e cila nuk do ta acaronte shumë Beogradin. Viktorit mund t'i jepej leje e përkohshme dhe e kufizuar për të drejtuar mesha në kishën ortodokse të Shkodrës. At Vasil Marko kërkonte që, para se të jepej kjo leje, duhej që Kisha Ortodokse Jugosllave ta njihnte zyrtarisht Kishën Ortodokse Shqiptare dhe pastaj t'i parashtronte drejtpërdrejt KOASH kërkesën për dhënien e lejes<sup>73</sup>.

Ndërkohë Ministria e Jashtme udhëzoi Legatën Shqiptare në Beograd që ta trajtonte çështjen e kishës serbe në Shkodër me autoritetet jugosllave. Ajo udhëzonte që të njoftohej Mitropoliti i Kishës Serbe se autoqefalia e Kishës Ortodokse Shqiptare ishte njohur zyrtarisht sipas rregullave kanonike që ishin në veprim. Kështu që Viktori nuk mund të njihet si peshkopi i asaj kisha. Ajo udhëzonte që të njëjtën përgjigje duhej t'i jepte edhe Kryetari i Këshillit Fetar, Viktorit të cilit t'i kërkonte t'u bindej rregullave kanonike<sup>74</sup>.

Në bisedën që zhvilluan diplomatët shqiptarë në Beograd me Patrikun jugosllav, ky pohoi, jo pa ironi, se e shihte fort të arsyeshme e të pëlqyeshme proklamimin e autoqefalisë së Kishës Ortodokse Shqiptare dhe njohjen e saj nga Patrikana e Stambollit, sipas rregullave kanonike. Ai shtoi se peshkopët e vjetër grekë në Shqipëri kishin qenë shumë shovinistë<sup>75</sup>. Por, ndërkohë, Viktori vijoi të intensifikonte aktivitetin e tij. Ai emëroi një sekretar dhe një shkronjë për arqipeshkvin ortodoks të Shkodrës, si dhe Lazar Metijeviçin si protopop.

<sup>69</sup> *AQSh*, Fondi: MPB, viti 1923, dos. 257, fl. 1-2. Kryetari i Këshillit të Lartë Kishtar, Vasil Marko-Kryeministrin A. Zogu, 19 janar 1923.

<sup>70</sup> *Po aty*, fl. 3. MPB-për Vasil Markon, 20 janar 1923.

<sup>71</sup> *Po aty*, dos. 27, fl. 2. Prefekti i Shkodrës, Suma-MPB, 21 janar 1923.

<sup>72</sup> *Po aty*.

<sup>73</sup> *Po aty*, fl. 7. Prefekti i Shkodrës, Suma-MPB, 18 janar 1923.

<sup>74</sup> *Po aty*, fl. 8. MPJ-MPB, 29 janar 1923.

<sup>75</sup> *Po aty*, fl. 16, MPJ-MPB, 5 shkurt 1923.

Prefektura e Shkodrës njoftonte se ky i fundit ishte major i shërbimit sekret jugosllav<sup>76</sup>. Edhe Ministri i Shqipërisë në Beograd, Ali Kolonja, informonte se Metijeviçi, ashtu si gjithë priftërinjtë e tjerë serbë, kishte shërbyer në ushtrinë serbe gjatë luftës. Ai kishte vepruar në qarkun e Shkodrës me uniformë oficeri, por të mbuluar me rasën e zezë<sup>77</sup>.

Viktori deklaroi se do të vinin në Shkodër edhe 4-5 priftërinj të tjerë në shërbim të “Arqipeshkvisë” dhe, si të mos mjaftonte kjo, po mbante një qëndrim të hapur armiqësor ndaj autoqefalisë së kishës ortodokse shqiptare. Ai kishte transferuar në Serbi priftin Mihal Striniqi, për arsye se ai kishte pranuar të dërgoheshin dy delegatë shkodranë në Kongresin e Beratit, ku u shpall Kisha Autoqefale Shqiptare. Viktori e konsideronte atë si partizan të kishës shqiptare dhe nuk kishte besim tek ai<sup>78</sup>. Viktori mbylli dhe kishën ortodokse të Shkodrës, duke ndaluar meshimin e priftit të mëparshëm, Miho Stirkiqit, për arsye se ai ishte prift i Kishës Autoqefale dhe se merrte rrogë prej asaj kishë<sup>79</sup>.

Këto veprime e zemëruan Ministrinë e Brendshme, e cila i kërkoi Kryeministrisë leje që ta dëbonte menjëherë Viktorin. Ministria e Brendshme urdhëroi Prefekturën e Shkodrës që të ndalonte hyrjen e dy priftërinjve të tjerë serbë në qytet. Njëri prej tyre ishte pop Buçina, i njohur si një politikan nacionalist serb<sup>80</sup>.

Gjendja e krijuar ishte aq shqetësuese, saqë Ministria e Jashtme vendosi të ndërmerre veprime të tjera në arenën ndërkombëtare. Ajo udhëzoi Legatat e tjera në Paris e në Romë dhe Konsullatën në Gjenevë që tu kërkonte qeverive italiane dhe franceze si dhe Sekretariatit të Lidhjes së Kombeve t’i jepnin këshilla qeverisë jugosllave për të mbajtur një qëndrim të moderuar dhe për të mos këmbëngulur në mbështetjen e kësaj veprimtarie e cila binte ndesh me rregullat kanonike<sup>81</sup>. MPJ i informoi këto qeveri se, menjëherë pas formimit të Kishës Autoqefale Shqiptare, Patrikana Serbe e Beogradit krijoi në Shkodër një “episkopatë” dhe dërgoi një episkop serb Viktorin. Mbasi kjo vepër e kishës serbe shkëlpte rregullat kanonike të ortodoksisë, kryetari i kishës shqiptare protestoi dhe shtrëngoi qeverinë të mos njohë “episkopatën” serbe në Shkodër.

<sup>76</sup> *Po aty*, fl. 86. Prefektura e Shkodrës-MPB, 31 janar 1923.

<sup>77</sup> *AMPJ*, viti 1923, dos. 332, fl. 54. Ministri i Shqipërisë në Beograd, Ali Kolonja-MPJ, 23 shkurt 1923.

<sup>78</sup> *AQSh*, Fondi: MPB, viti 1923, dos. 27, fl. 18. Prefektura e Shkodrës-MPB, 13 shkurt 1923.

<sup>79</sup> *Po aty*, fl. 38. Komisari i Policisë Shkodër-Prefekturës Shkodër, 18 shkurt 1923.

<sup>80</sup> *Po aty*, fl. 24, 25.

<sup>81</sup> *AMPJ*, viti 1923, dos. 332, fl. 28-29. Udhëzime të MPJ drejtuar Legatave në Paris dhe në Romë dhe Konsullatës në Gjenevë, 24 shkurt 1923.

Qeveria jugosllave protestoi kundër masave që mori qeveria shqiptare. Kjo u përgjigj se e drejta ekskluzive për krijimin e episkopatave dhe emërimin e episkopëve në Shqipëri i takonte vetëm Kishës Autoqefale Shqiptare dhe se vetëm prifti i mëparshëm, pasi të hynte në marrëdhënie të drejtpërdrejta me kryetarin e kishës shqiptare, do të mund të vazhdonte meshat si dhe më parë. Në qoftë se qeveria shqiptare do të vepronte ndryshe mund të krijonte një "fait accompli" me përfundime të rrezikshme për pavarësinë fetare të shtetit tonë<sup>82</sup>.

Legata shqiptare në Romë e trajtoi këtë çështje, jo zyrtarisht, sipas instruksioneve që i kishte dhënë Ministria e Jashtme. Zyrtarët e lartë të Farnezinës, Gabi dhe Markezi Durrazzo, u përgjigjën se do ta studionin problemin dhe do të jepnin një përgjigje nëse qeveria italiane e vlerësonte oportune një ndërhyrje të saj në Beograd për t'i dhënë këshilla qeverisë serbe që ajo të mbante një qëndrim të moderuar<sup>83</sup>.

Më 21 shkurt Ministria e Brendshme kërkoi që paralelisht me përpjekjet diplomatike të merreshin edhe masa në rrugë kanonike. At Vasil Marko duhej të emëronte dy-tre priftërinj në Shkodër, sepse mungesa e tyre po i inkurajonte priftërinjtë serbë<sup>84</sup>. Me afrimin e pashkëve ortodokse, edhe Prefektura u shqetësua nga që kisha po mbahej e mbyllur nga Viktori. Ajo kërkonte dërgimin me urgjencë të një prifti nga Kisha Autoqefale Shqiptare<sup>85</sup>.

Për t'i dalë përpara situatës, Kryetari i Kishës Shqiptare, At Vasil Marko, propozoi një zgjidhje kompromisi. Ai informoi prefektin e Shkodrës se çdo klerik, i çdo niveli, duhej t'i drejtohej Kryekishës, bashkë me dokumentet e dorëzimit. Pastaj atij mund t'i jepej leje për një kohë të caktuar, pasi të pëlqehet prej Këshillës së Lartë Kishtare, me kusht që ai të vepronte sipas ligjeve të shtetit shqiptar dhe ligjit për Kishën Ortodokse Autoqefale<sup>86</sup>.

Ministria e Brendshme sugjeroi që në Shkodër të shkonte papa Jani dhe një prift nga Pogradeci, i cili dinte të meshonte në sllavisht. Edhe këta do të dërgoheshin me qëndrim të përkohshëm në Shkodër pasi t'u jepej leja nga kryesia e Kishës Autoqefale. Ndërsa Viktori nuk do të lejohej në asnjë mënyrë të zhvillonte mesha<sup>87</sup>. Këto masa u zbatuan dhe kisha ortodokse e Shkodrës u çel më 6 prill kur u kryen ceremonitë fetare të rastit. Meshën e zhvilloi peshkop Miho, ndërsa Viktori nuk mori pjesë<sup>88</sup>.

Më tej, I Ngarkuari me Punë i Jugosllavisë i deklaroi Ministrisë së Jashtme të Shqipërisë se qeveria jugosllave e quante çeljen e kishës së

<sup>82</sup> *Po aty*.

<sup>83</sup> *Po aty*, fl. 51-52. Legata Shqiptare në Romë-MPJ, 13 mars 1923.

<sup>84</sup> *AQSh*, Fondi: MPB, viti 1923, dos. 27, fl. 26.

<sup>85</sup> *Po aty*, fl. 47. Prefektura e Shkodrës-MPB, 19 mars 1923.

<sup>86</sup> *AMPJ*, viti 1923, dos. 332, fl. 105. Prefektura Shkodrës-MPB, 27 mars 1923.

<sup>87</sup> *AQSh*, Fondi: MPB, viti 1923, dos. 27, fl. 54-55.

<sup>88</sup> *Po aty*, fl. 67.

Shkodrës një problem thjesht eklesistik dhe jo politik. Pra ajo linte të kuptohej se për zgjidhjen e saj do të ishin kompetente vetëm Kisha Ortodokse Serbe dhe Këshilli i Lartë Kishtar i Korçës<sup>89</sup>. Por, në të njëjtën kohë, ministri i Jashtëm jugosllav, Niniç, dha sinjale të qarta se kjo çështje do të trajtohej pa përfillur palën shqiptare. Ai kishte deklaruar se çështja e kishës, e lindur nga shpallja e Kishës Autoqefale të Shqipërisë në ato qarqe, të cilat më parë ishin nën juridiksionin e Peshkopatës së Prizrenit, Pejës dhe Ohrit, do të zgjidhej nga një komision i posaçëm, i cili po diskutonte me Patrikanën e Stambollit për të gjetur një zgjidhje. Këtë zgjidhje do ta ndihmonte diplomacia serbe dhe ajo do të pasohej nga një marrëveshje me Patrikanën Serbe<sup>90</sup>.

Më pas Ministria e Brendshme informoi Ministrinë e Drejtësisë se Viktori ishte ndaluar të meshonte sepse ai kërkonte të vepronte si peshkop lokal i pavarur i Shkodrës. Por autoritetet shqiptare kishin vendosur të mbanin një qëndrim të moderuar dhe, nëse ai dëshironte të meshonte si peshkop mysafir, nuk do të ndalohej<sup>91</sup>. Këtë qëndrim ia komunikoi Viktorit edhe Prefektura e Shkodrës më 3 nëntor 1923<sup>92</sup>. Viktori nuk dha ndonjë përgjigje të qartë për këtë ofertë, por shprehu lutjet e tij “për mbarëvajtjen e shtetit shqiptar”<sup>93</sup>.

Dukej qartë se ky ndryshim i qëndrimit të Ministrisë së Brendshme kishte ardhur si pasojë e ndërhyrjes së Arqimandrit Visarionit, i cili theksonte se, sipas rregullave kishtarë, Viktori kishte të drejtë me u lut në kishë për nevojat e veta. Ndalimi i tij nga administrata shkelte lirinë fetare, ligjin dhe statutin dhe dëmtonte kështu shtetin dhe kishën ortodokse shqiptare, duke e ekspozuar keq shtetin shqiptar jashtë. Ai i shkruante Ministrinë të Drejtësisë se këtë pikëpamje e kishte formuar nga udhëtimi i gjatë në Jugosllavi si dhe nga diskutimet që kishte pasur me autoritetet e larta kishtarë e politike të Mbretërisë Jugosllave. Prandaj ai kërkoi që Viktori të meshonte sa herë të donte, pa u përzier në administratën kishtarë dhe jo me cilësinë e episkopit të Shkodrës, por vetëm si mysafir ose si mik<sup>94</sup>.

Në përpyekje për ta qetësuar situatën dhe për të ulur tensionin me palën jugosllave, qeveria bëri një hap tjetër të rëndësishëm në favor të banorëve të Vrakës. Ajo bindi pronarin e madh Sulçe Bej Bushatin, që t'u shiste bujqve të Vrakës tokat e tij. Ky ishte një lëshim i madh që u pranua me dhimbje nga pronari, pasi qeveria ushtroi presion të fortë ndaj tij nëpërmjet bisedimeve të

<sup>89</sup> *Po aty*, fl. 76. MPJ-MPB, 12 qershor 1923.

<sup>90</sup> “Deklaratë e Ministrisë të Jashtëm Jugosllav për Shqipërinë”, *Gazeta e Korçës*, 12 qershor 1923.

<sup>91</sup> *AQSh*, Fondi: MPB, viti 1923, dos. 27, fl. 90. MPB-Ministrisë së Drejtësisë.

<sup>92</sup> *Po aty*, fl. 85. Prefektura e Shkodrës-Peshkop Viktorit, 3 nëntor 1923.

<sup>93</sup> *Po aty*, fl. 86. Viktori-Prefektit të Shkodrës.

<sup>94</sup> *Po aty*, fl. 108-109. Arqimandrit Visarioni (deputet i Durrësit) për Ministrinë e Drejtësisë, 10 gusht 1923.

gjata ku ndërhyjnë shumë miq të Sulçe Begut<sup>95</sup>. Përfitimi i bujqve të Vrakës ishte shumë më i madh se sa interesat e tyre për problemet eklestike.

Megjithatë Viktori nuk hoqi dorë nga përpjekjet e tij dhe problemi eklestik vijonte të shqetësonte qeverinë shqiptare. Në prill të vitit 1924, Ministria e Jashtme i tërhoqi vëmendjen Ministrisë së Brendshme se peshkop Viktori po meshonte në kishën e Shkodrës. E shqetësuar, ajo shkruante se kështu do të shkonin dëm përpjekjet e mëdha që kishte bërë pranë qeverisë jugosllave dhe pranë Fuqive të Mëdha, të cilat kishin rezultuar në zgjidhjen e problemit në favor të Shqipërisë<sup>96</sup>. Prefektura e Shkodrës, në përgjigje të këtij shqetësimi, informonte se Viktori i ishte dhënë leje të meshonte për të përmbushur nevojat personale religjioze si prift mysafir, në bazë të urdhrit që kishte dhënë Ministria e Brendshme më 18 tetor 1923<sup>97</sup>.

Ndërkohë që ziente çështja kishtare, në vitin 1924 u rihap edhe problemi i shkollës serbe të Shkodrës. Ministria e Arsimit informoi MPJ se në këtë shkollë nuk po mësohej gjuha shqipe, gjë që ishte në kundërshtim me parashikimet e Deklaratës që kishte bërë Shqipëria në Lidhjen e Kombeve<sup>98</sup>. Gjithashtu Ministria e Arsimit vinte në dukje se shumica e fëmijëve që shkonin në atë shkollë flisnin në familjet e tyre gjuhën shqipe. Ministria e Jashtme miratoi kërkesën e Ministrisë së Arsimit dhe sugjeroi që shkolla të mbyllej në qoftë se nuk do të mësohej gjuha zyrtare, historia dhe gjeografia e Shqipërisë<sup>99</sup>.

Shkolla ortodokse e Shkodrës mbajti një qëndrim arrogant kundërshtues ndaj këtyre detyrimeve ligjore që ishin në përputhje me Traktatet e LK për mbrojtjen e minoriteteve dhe nuk e pranoi mësuesin e emëruar për të dhënë gjuhën shqipe, gjeografinë dhe historinë e Shqipërisë, me pretendimin se dhënia e këtyre lëndëve ishte kompetencë e drejtorisë së shkollës. Kështu, duke ju përgjigjur këtij qëndrimi, Prefektura e Shkodrës, më 25 shtator 1924, dha urdhrë që shkolla të mbyllej derisa të pranohej mësuesi dhe programi i Ministrisë së Arsimit<sup>100</sup>.

Si përfundim mund të thuhet se shteti shqiptar në këtë fazë u përpoq të respektonte detyrimet që kishte marrë për mbrojtjen e minoriteteve por ai u ndesh me përpjekjet e vendeve fqinje të cilat synonin të shkonin përtej këtyre angazhimeve dhe rregullave ndërkombëtare. Në qëndrimet e qeverisë shqiptare viheshin re si dëshirat dhe qartësia e saj për të ndjekur një politikë liberale ndaj pakicave, të cilën e konsideronte si një faktor të rëndësishëm për marrëdhënie të fqinjësisë së mirë dhe si një aset në favor të paqimit me fqinjët e saj, ashtu

<sup>95</sup> *Po aty*, dos. 177, fl. 4. Ministri i Luftës, I. Tatzati-Kryeministrisë, 23 maj 1923.

<sup>96</sup> *Po aty*, viti 1924, dos. 21, fl. 2. MPJ-MPB, 12 prill 1924.

<sup>97</sup> *Po aty*, viti 1924, dos. 21, fl. 3. Prefektura e Shkodrës-MPB, 18 maj 1924.

<sup>98</sup> *Po aty*, dos. 99, fl. 3. Ministria e Arsimit-MPJ, 18 mars 1924.

<sup>99</sup> *Po aty*, fl. 1. MPJ-Ministrisë së Arsimit, 18 mars 1924.

<sup>100</sup> *Po aty*, dos. 685, fl. 5-6. Nënprefekti i Shkodrës, Mustafa Kruja-MPB, 23 shtator 1924.

evidentohej edhe fakti i hidhur i pozitës së dobët ndërkombëtare dhe i vështirësive të brendshme, të cilat e shtynin Tiranën të bënte edhe lëshime në linjën e kapitulacioneve të vjetra që kishin ekzistuar në Perandorinë Osmane.

### *S u m m a r y*

#### THE STAND OF THE ALBANIAN STATE TOWARD THE ETHNO-CULTURAL MINORITIES OF THE VLACHS AND THE MONTENEGRIN ONE DURING 1920-1924

The Albanian government with its declaration for the minorities in the League of Nations in 2 September 1921 adopted a liberal policy toward them. In this period the Vlachs achieved some successes. The Vlach schools that had functioned before the WWI were opened in the area of Korça.

The Albanian authorities were sympathetic to the Vlach population and allowed the opening of some schools and Aromanian churches. However they were reluctant to increase the number of schools in the level demanded by some representatives of the Vlachs while being concerned that such concessions would increase the Greek pressure toward Albania and would have created obstacles to the national unification process.

A part of the Albanian Diaspora in Romania and the newspaper "*Shqipëria e Re*" (New Albania) supported the advancement of the demands of the Vlachs to increase the number of the Romanian schools while echoing the Albanian-Romanian and Albanian-Vlach friendship. Also it highly esteemed the participation of some Vlachs as members of Albanian Parliament and the subsidization of the Vlach schools by the Albanian government. The government in the majority of the cases it tolerated the activity of the teachers with foreign citizenship in Aromanian schools something that was prohibited by the Treatises of the League of the Nations for the minorities. The Romanian government endeavoured to advance the status of the Vlachs. However, in the meantime it had not yet recognized the Albanian state, something that had raised critics in the Romanian parliament.

Considering the friendly stand of the Albanian government a large number of Vlachs from Greece came and settled in Albania by also taking the Albania citizenship. The Albanian authorities created all the needed facilities for the granting of the citizenship and facilitating them from all the customs taxes for the livestock that brought with them.

A tolerant stand was maintained also toward the modest Montenegrin minority in Vraga in the region of Shkodra. Conversely, during these years the Albania state and the Albanian Orthodox Church were faced with the interference of the Serbian Orthodox Church and Yugoslav state, which by using this minority tried to control the orthodox church of Shkodra and to extend their influence in the Synod of the Albanian Orthodox Church

The Albanian government it kept open the Slavic school of Vraga, respected the Sllavic Orthodox Church of Vraga and obliged the Albanian landowner Sulçe bej Bushati to sell his properties to the farmers of this village. Also the Serb bishop Victor was allowed to hold masses as a guest in the Orthodox Church of Shkodra.